

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

FUSHA: GJUHËT E HUAJA
PËR KLASËN E 10^{te}-12^{te}

TIRANË, 2010

AUTOR:

VJOLETA KRAJA
GISELA SELITA
VALBONA SELMANI
ALEKSANDER PRENGA

Sayings and quotations about foreign languages

“...Language sets you in a corridor for life. Foreign languages open every door along that way...”
Frank Smith

“...Those who know a foreign language know much more of their mother tongue...”
- Johann Wolfgang von Goethe

“...Bilingualism and multilingualism is diversity, tolerance, understanding, richness, power and celebration...”

“...Through learning a foreign language, we learn about culture. Through learning about culture, we learn respect for others. Through learning respect for others, we can hope for and build peace...”

“...Learning to speak another’s language means taking one’s place in the human community. It means reaching out to others across cultural and linguistic boundaries. Foreign language is far more than a system to be explained. It is our most important link to the world around us. Foreign language is culture in motion. It is people interacting with people...”

Sandra Savignon, Communicative Competence: Theory & Classroom Practice.

“...If you talk to a man in a language he understands, that goes to his head. If you talk to him in his language, that goes to his heart...”

- Nelson Mandela

Udhëzuesi kurrikular i Gjuhëve të Huaja (klasa 10-të, 11-të dhe 12-të), është një material ndihmës kryesisht për mësuesit e gjuhëve të huaja por edhe për përdoruesit e kurrikulës së gjuhëve të huaja si dhe për aktoret dhe grupet e tjera të interesit të kësaj fushe. Ky udhëzues ndihmon në zbatimin e programit mësimor të gjimnazit në lëndët e gjuhëve të huaja dhe sugjeron metoda të suksesshme të mësimdhënies, të nxënies, vlerësimit dhe vetëvlerësimit të nxënësve në gjuhë të huaj.

Përmbajtja

1. Gjuhët e huaja në kurrikulën e re të gjimnazit

1.1 Synimet e kurrikulës së re, përmbajtja, struktura e programit

1.2 Aftësitë bazë dhe mësimdhënia e mësim-nxënia në gjuhë të huaj

1.3 Fusha dhe përmbajtja

1.4 Mundësitë kurrikulare për integrimin e gjuhës së huaj me lëndët dhe fushat e tjera

1.5 Klasifikimi i objektivave të arritjes sipas Blumit

1.6 Objektivat specifike të arritjes në gjuhë të huaj

2. Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës

3. Vlerësimi i nxënësit

1. Gjuhët e huaja në kurrikulën e re të gjimnazit

1.1 Synimet e kurrikulës së re, përmbajtja, struktura e programit.

Gjuha e huaj është planifikuar në kurrikulën bërthamë të gjimnazit si një lëndë me rëndësi në formimin nxënësve. Në kontekstin e sotëm social dhe politik ku lidhjet me Evropën janë gjithnjë dhe më të qenësishme si dhe ku Shqipëria aspiron të integrohet, prirja kryesore është krijimi i një mjedisi plurilinguist e shumëkulturore, në të cilin, mësimi i gjuhës së huaj kontribuon jo vetëm për formimin gjuhësor dhe kulturor të nxënësve, por ka një ndikim të veçantë në shkëmbimet kulturore midis vendit tonë dhe vendeve të ndryshme.

Të nxënit e gjuhës së huaj do të mundësojë integrimin gjithnjë e më të shpejtë të nxënësit shqiptar në një realitet shumë gjuhësor dhe kulturor.

Aftësimi i nxënësve në gjuhën e huaj krijon kushte për njohjen e thellimin në vlerat kulturore të pjesës tjetër të botës si dhe prezantimin dhe shpalosjen e vlerave tona kombëtare ndërmjet kulturës së popujve të tjerë evropianë.

Një përvetësim i mirë i gjuhës së huaj do të ndihmojë nxënësit në aftësimin e tyre për të nxënit gjatë gjithë jetës, për të përdorur gjuhën e huaj në vendimmarrje që ndikojnë në përparimin e tyre si individ dhe të komunitetit që e rrethon në nivel lokal e kombëtar.

Kurrikula e gjuhës së huaj në gjimnaz u mundëson të gjithë nxënësve, falë mundësive që krijojnë sot teknologjitë e reja të informatikës, pasurimin e thellimin e dijeve në fusha të ndryshme të zhvillimit shkencor në botën e përparuar, njohjen dhe pasurimin me dokumente të larmishme,

duke thelluar aftësitë e tyre njohëse si dhe duke i përgatitur për veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë mësimit.

Materialet burimore në shërbim të nxënës do të jenë të larmishme, krahas dokumentit burimor tekstit që zë një vend të rëndësishëm, dokumente të ndryshme pamorë dhe zanorë mund të përdoren nga nxënësit dhe mësuesi për ilustrimin e temave, ideve, që trajtohen në mësimin e gjuhës së huaj. Veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë procesit mësimor, në shërbim të mësuarit të gjuhës së huaj do të jenë të pranishme në zbatimin e programit të 10 -të të gjuhës së huaj.

Përvetësimi i gjuhës së huaj për shumë të rinj do t'i shërbejë mundësisë së shkollimit në vendet evropiane, duke krijuar kështu një bazë të domosdoshme gjuhësore për studimet e mëtejshme universitare, thënë ndryshe do të nxitë nxënësit për të hedhur hapat e parë të sigurt në karrierën profesionale.

Kurrikula e gjuhës së huaj 10-të - 12-të ndihmon jo vetëm pasurimin dhe lulëzimin e individualitetit të nxënësit, por edhe ndërtimin e qëndrimeve dhe sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe që krijojnë një qytetar të ri, ndërtues i një të ardhme evropiane, në bazë të së cilës do të jenë vlerat kombëtare si dhe këmbimet e gjithanshme në shërbim të bashkëpunimit dhe progresit .

Duke iu referuar nivelit të arritur deri në klasën e nëntë dhe përshkruesve të aftësive sipas *Kuadrit Evropian të Përgjithshëm të Referencave*, kurrikula e gjuhëve të huaja 10-të - 12-të synon të realizojë nivelin B2 nivel i cili duhet të shfaqet në arritjet e nxënësit në katër kompetencat e domosdoshme për përvetësimin e gjuhës së huaj.

Synimi:

Kurrikula gjuhës së huaj në gjimnaz synon që të gjithë nxënësit të zhvillojnë njohuri gjuhësore e social-kulturore, aftësi, qëndrime për

probleme dhe tema të ndryshme, të cilat lidhen ose jo me realitetin ku nxënësit jetojnë, duke synuar një komunikim ndërkombëtar më të efektshëm, i cili të respektojë identitetet kulturore, e vlerat kombëtare në përgjithësi.

Njohuritë:

Nxënësit do të mësojnë fjalë dhe shprehje të reja si dhe përdorimet e tyre në kontekste e situata të ndryshme të ligjëritimit. Po kështu nxënësit do të përvetësojnë njohuri dhe kuptime për strukturën e fjalisë dhe përbërësit e saj, për ndërveprimet ndërmjet pjesëve morfologjike në fjali. Nxënësit do të ushtrohen të përdorin kuptimet përkatëse të fjalëve dhe shprehjeve për të interpretuar, integruar, dhe zgjeruar njohuritë e tyre në gjuhë të huaj.

Aftësitë:

Mësimi i gjuhës së huaj në shkollë do të orientojë nxënësin drejt përvetësimit aktiv të informacionit gojor dhe të shkruar në gjuhë të huaj, duke e vlerësuar këtë të fundit në kontekste të ndryshme gjuhësore, sociale apo kulturore.

Aftësimi i të dëgjuarit, i të shprehurit me gojë dhe me shkrim në gjuhë të huaj përbëjnë një tipar të rëndësishëm të kurrikulës së kësaj lënde. Zhvillimi i këtyre dy aftësive ndihmon nxënësin që të thellohet pa e kuptuar në qëndrimet e tij ndaj problemeve e fenomeneve të botës që e rrethon.

Nxënësit duke studiuar strukturën e ligjëritimit në gjuhë të huaj, duke u thelluar, në sistemin foljor të gjuhës, në rendin e fjalëve në fjalinë e thjeshtë dhe atë të përbërë, në ndërveprimet e elementëve të ndryshëm morfologjikë si dhe përshtatjet që fjalët pësojnë gjatë këtij bashkëveprimi, do të zhvillojnë aftësi të kërkimit shkencor, të zgjidhjes së problemeve, të komunikimit të ideve.

Qëndrimet:

Nxënësit duke studiuar gjuhën e huaj do të rritin interesin dhe

njohuritë në fusha të veçanta qofshin shkencore apo social kulturore, do të ndërjegjësohen për strukturën dhe format e përdorimit të gjuhës së huaj, do të nxiten të zhvillojnë qëndrime që mbështesin përvetësimin e përgjegjshëm të informacioneve shkencore si dhe aplikimin e njohurive për përfitime individuale, shoqërore dhe mjedisore.

Kurrikula e re synon gjithashtu të mësojë nxënësit për të punuar në grup, për të marrë vendime të rëndësishme për pjesëmarrje dhe kontribut në veprimtari të përbashkëta të shkollës, lokale, apo dhe më tej. Të jetë aktiv në projektet e nismat e ndryshme që i shërbejnë edukimit në shkollë dhe komunitetit.

Teksti si dokumenti burimor bazë në përdorim të nxënësit është një dokument i rëndësishëm në të cilin krahas pasurimit të njohurive leksiko – gramatikore, nxënësit vihen përballë dokumentesh dhe vlerash të panjohura që i përkasin një mjedisi tjetër socio-kulturor. Duke ju përgjigjur kërkesave të aparatit metodologjik të vetë tekstit dhe linjave të tij nxënësi nxitet të krahasojë, të mbajë qëndrim ndaj fenomeneve të ndryshme që bëjnë pjesë ose jo në jetën e përditshme të tij por që e nxitin drejt një bote të re, drejt integritimit evropian.

Përzgjedhja e tematikave, nën-linjat në tekst mundësojnë ndërveprimin e gjuhës së huaj me lëndë të tjera të kurrikulës si historia, shkencat sociale, artet etj.

Përmbajtja

Mësimdhënia dhe mësim-nxënia e gjuhës së huaj në gjimnaz, synon të zgjerojë dhe thellojë njohuritë, konceptet dhe aftësitë e fituara në arsimin e detyruar nëntëvjeçar, duke nxitur diskutimin krijues, mbajtjen qëndrim ndaj tematikave që shtrohen në dokumentet e ndryshme burimore, për të mundësuar përgatitjen e nxënësve për studime të mëtejshme, për punë dhe për jetë duke synuar për t'u bashkëngjitur vlerave evropiane vlerat tona kombëtare.

Në kurrikulën e gjuhëve të huaja tematikat e jetës së përditshme si pushimet, shkolla, problemet e mjedisit, reklama dhe konsumi përbëjnë fusha të thellimit dhe diskutimit në mësimin e gjuhës së huaj, në përgjithësi.

Studimi i këtyre çështjeve është konceptuar si vijim i njohurive të marra në sistemin nëntëvjeçar.

Në lëndën e gjuhës huaj është planifikuar krahas njësive leksikore të thellohen njohuritë për konceptet e përcaktorëve të emrit, të studiohen konceptet bazë të fjalëformimit në gjuhën e huaj, rendi i pjesëve në fjali dhe produkti semantik që lind nga zhvendosja dhe ndryshimi i tij, si dhe konceptet e modalitetit, sistemi foljor etj.

E gjithë puna e organizuar në klasë në linjat e nën-linjat, synojnë përgatitjen e nxënësit sipas Standardeve të Fushës së Gjuhëve të Huaja të gjimnazit të hartuar nga IZHA, si dhe sipas niveleve të parashikuara në Kuadrin Evropian të Referencave për Gjuhët. Kështu duke ju përgjigjur në të njëjtën kohë dhe synimeve të kurrikulës bazë e gjithë puna duhet të synojë objektivat e nivelit B2 të Kuadrin Evropian të Referencave për Gjuhët.

Formati i Programit

Lënda gjuhës së huaj në kurrikulën bërthamë të gjimnazit zë një vend të rëndësishëm në kurrikulën 10-të - 12-të dhe është organizuar respektivisht sipas rubrikave të mëposhtme:

1. Hyrje
2. Synimi i lëndës
3. Objektiva të përgjithshme
4. Objektivat e përmbytjes dhe objektivat sipas aftësive
5. Integrimi ndërlëndor dhe kërkesa ndaj lëndëve të tjera
6. Kërkesa për zbatimin e programit
7. Metodologjia e mësimdhënies
8. Vlerësimi.

Struktura e Programit

Gjuha e huaj në kurrikulën bërthamë të gjimnazit zhvillohet përkatësisht në klasat 10-të dhe 11-të me tre orë në javë dhe në klasën e 12-të me 4 orë në javë.

Klasa	Orë/javë	Javë	Gjithsejt
10	3 orë	36	108 orë
11	3 orë	36	108 orë
12	4 orë	34	136 orë

Mësuesi në planin analitik vjetor/semestral planifikon shpërndarjen e orëve sipas objektivave mësimorë për tema të veçanta, pa neglizhuar planifikimin vjetor 70% të orëve të mësimit për shtjellimin e njohurive të reja dhe 30% e përpunimit të njohurive në përgjithësi.

Konceptimi i programeve bazuar në objektivat mësimore është një proces në dukje i vështirë por mjaft inkurajues në zbatimin e detyrës së mësuesit. Kjo formë e të konceptuarit të programit, të punës së mësuesit në klasë e ndihmon mësuesin të administrojë sa më mirë orën e mësimit, të organizojë procedura metodologjike që favorizojnë arritjen e objektivave; veprimtari didaktike në klasë dhe jashtë saj që nxitin përvetësimin e njohurive nga ana e nxënësit.

Nga pikëpamja strukturore ky program sjell elementë të rinj të planifikimit dhe programimit kurrikular. Këto elementë ndikojnë në rritjen e shkallës së fleksibilitetit të zbatimit të programit nga ana e mësuesve. Kështu nëse për temën e pushimeve jepen tre dokumente tekstuale, mësuesi zgjedh në vartësi të objektivit për orën e mësimit njërin nga dokumentet dhe procedurën metodologjike, pikërisht ato që i përshtaten më shumë objektivit të orës së mësimit planifikuar prej vetë atij, interesit dhe nivelit të nxënësve në klasë.

OBJEKTIVA MËSIMORE TË PROGRAMIT

Duke e konsideruar gjuhën e huaj një lëndë, me të cilën nxënësi ka ndërtuar tashmë raportet e tij të para, duke konsideruar atë çka është arritur në arsimin nëntë vjeçar, si dhe gjuhën e huaj një lëndë me një diapazon të gjerë kulturor ku nxënësi është i lirë të shprehet për dokumente të ndryshme burimore, duke shprehur dhe idetë, pikëpamjet dhe qëndrimet e tij, programet mësimore të kurrikulës së re në ndryshim nga programet e deritanishme nuk përshkruajnë përmbajtje tematike mësimore, por një tërësi objektivash mësimore të renditura sipas linjave që inkuadrohen në kornizën e Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët.

Linjat /nënlinjat e përmbajtjes.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj i përmbahet përmbajtjes mësimore e cila bazohet në linjat e përmbajtjes. Secila linjë e përmbajtjes përfshin në vetvete një tërësi çështjesh mësimore që lidhen me një tematikë të caktuar, me një objekt të caktuar studimi. Për shembull, nëse lexojmë apo flasim për turizmin dhe udhëtimet sigurisht krahas koncepteve gramatikore të domosdoshme për ligjërimin, perceptimin apo transmetimin e mendimit, është e domosdoshme zotërimi i një fjalori bazë të natyrës dhe peizazhit natyror, të fushës së mjeteve të transportit, fjalori të fushës së shprehjes të qëndrimeve e ndjenjave, tërësi këto të domosdoshme në perceptimin apo komunikimin me shkrim dhe me gojë.

Objektivat mësimore

Në programin e gjuhës së huaj kemi tre blloqe të përmbajtjes (komunikimi, kultura dhe elementet gjuhësore) dhe çdo grup temash shoqërohet me disa objektiva mësimore. Objektivat mësimore në program përshkruajnë përmbajtjet mësimore bazë që do të studiohen nga nxënësit në nën-linjën e përcaktuar, arritjet e pritshme mësimore për të gjithë nxënësit, ashtu si dhe

metodologjinë e studimit dhe atë të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

- ✓ Objektivi na sinjalizon për **përmbajtjen mësimore** të cilën nxënësi duhet të nxërë. P.sh në objektivin: “nxënësi të përshkruajë udhëtimin e tij të preferuar” ne nënkuptojmë që nxënësi duhet të shprehet në gjuhë të huaj, përkatësisht për zgjedhjen e tij në raport me udhëtimet.
- ✓ Një objektivi na informon për **arritjen mësimore** të nxënësit gjatë procesit të nxënies lëndore. P.sh përmes objektivit:” *Nxënësi shkruan karakteristikat e peizazhit natyror*” ne kuptojmë se në fund të procesit mësimor nxënësi duhet të shkruajë termat bazë që karakterizojnë peizazhin natyror.
- ✓ Një objektivi, na jep gjithashtu **informacion për metodën mësimore**. P.sh në objektivin në vijim: “*Nxënësi përshkruan mjetet e udhëtimit në Shqipëri*”. Përmes këtij objektivi mësuesi kupton që në zhvillimin e përmbajtjes mësimore për turizmin dhe peizazhin natyror nxënësi do të zbatojë metodën e përshkrimit.
- ✓ Objektivi na **informon dhe në drejtim të planifikimit të vlerësimit të nxënies**. Le ta zbërthejmë këtë në shembullin e objektivit “*nxënësi të përshkruajë mjetet e udhëtimit në Shqipëri duke cituar aspekte pozitive dhe negative nga eksperiencia e tij vetjake apo nga njohuri të marra në mjedisin që e rrethon*”. Ky objektivi imponon që arritjen e nxënësit ta vlerësojmë jo thjesht me gojë apo me shkrim por në këtë objektivi ajo çka është më e rëndësishme dhe ku duhet të vihet theksi në vlerësim është të vlerësohet mbajtja qëndrim ndaj mjeteve të udhëtimit, mënyrës së udhëtimit duke cituar anën pozitive apo negative (kjo si konkluzion i një eksperience vetjake apo të rrëfyer).

Përparësi të programeve me bazë objektivat mësimore

Kurrikula lëndore e bazuar në programet e ndërtuara me anë të objektivave lëndore nënkupton përmbajtjet, materialet dhe veprimtaritë

mësimore të planifikuara dhe realizuara në mënyrë që nxënësit të arrijnë objektivat mësimore të programeve lëndore.

Objektivat konsiderohen elementi i parë në kurrikulën bërthamë. Pikërisht janë objektivat ato që paraprijnë hartimin e kurrikulës. Përmbajtja, metodologjia, vlerësimi në kurrikulën e bazuar në objektiva të nxënies, përcaktohen gjithnjë duke marrë në konsideratë këto objektiva.

Realizimi i objektivat mësimore në një lëndë të veçantë ndikon ndjeshëm në realizimin e arritjeve, të objektivave të nxënies të lëndëve të tjera duke krijuar kështu atë që ne e quajmë *lidhje ndër-lëndore*, fenomen që ndikon fuqimisht në formimin e nxëniesit.

Midis kurrikulës së bazuar në objektivat lëndore (programet e reja lëndore të gjimnazit) dhe kurrikulës të bazuar në programe tematike (programet e vjetra) ka shumë ndryshime. Ndërsa objektivat pohojnë dhe formulojnë cilësinë e kriterëve, njohuri dhe dije që nxënësi duhet të dijë, shprehi dhe qëndrime që nxënësi duhet të dijë dhe të mbajë; programi tematik lëndor vetëm liston në mënyrë të njëjtë tema dhe çështje rreth objektit lëndor të shtrira në njësinë e kohës, të ndara në kapituj apo grup temash.

Kurrikula e mbështetur në programe të ndërhuara me objektiva mësimore ndihmon mësuesin për të planifikuar mësimdhënien në vartësi të nivelit individual të nxëniesit, duke konsideruar arritjet e tij në sistemin nëntëvjeçar, duke hartuar objektiva më të përshtatshme që nxitin veprimtari mësimore më efikase për grupin dhe secilin nxënës në veçanti. Kurrikula e deritashme bazohej thjesht në tematikat pa marrë në konsideratë nivelin dhe problemet që duhet të konfrontonin nxëniesit dhe mësuesi në orën e mësimit.

Kurrikula e mbështetur në programe të ndërhuara me objektiva mësimore ndihmon mësuesin dhe nxëniesin për një vlerësim dhe vetëvlerësim nga ana e nxëniesit mbi arritjen e objektivave, vlerësimin të arritjeve duke patur të qartë dhe përvetësuar nga ana e nxëniesit dhe vlerësuar nga ana e mësuesit atë çka është më e rëndësishmja.

Kjo kurrikulë në ndryshim me kurrikulën bazuar në tematika u krijon

lehtësinë nxënësve për përdorimin e materialeve suplementare, shtesë rreth një çështje të caktuar.

Për të përfunduar mbi përparësitë e kurrikulës me objektiva ndaj asaj, bazuar në tematikë mjafton të vëmë në dukje faktin që bashkëpunimi pan-evropian dhe në fushën e arsimit, i qenësishëm në formën më të detajuar në Kuadrin Evropian të Referencave, vendos mësimdhënien, veçanërisht formimin e nxënësit në gjuhë të huaj plotësisht në shërbim të interesave konkrete të arsimit dhe punësimit.

Ndryshimet që sjellin në kurrikul programet lëndore të bazuara në objektiva mësimore

1- Vendosjen reale të nxënësit në qendër të formimit dhe të edukimit.

Sipas kurrikulës me objektiva nxënësi në përvetësimin e dijes ndjehet më i pavarur nga mësuesi dhe fiton më shpejt pavarësinë dhe sigurinë e të shprehurit në gjuhë të huaj kjo dhe falë mundësive që krijon vetë gjuha e huaj për formimin dhe edukimin.

2- Pasurimi i materialeve burimore të mësuarit

Objektivat si bazë e kurrikulës përcaktojnë qartë atë çka mësuesi dhe nxënësi duhet të arrijnë gjatë orës së mësimit duke u lënë mundësi të lirë nxënësve për përzgjedhje materialesh të ndryshme burimore për konkretizimin e objektivit të caktuar.

3- Pasuron metodologjinë e mësimdhënies me larmi formash e veprimtarish të reja në shërbim të mësimdhënies.

Duke konsideruar faktin që mësuesit e gjuhës së huaj kanë mundësinë në sajë të teknologjive të reja informatike të kenë kontakt me metodologjinë moderne aktuale, të përparuar të mësimdhënies së gjuhës së huaj, programet e reja krijojnë mundësi për më tepër liri profesionale,

përmes së cilës ata mund të kërkojnë dhe të gjejnë pa fund forma pune për mësimdhënien larg arsimimit me anë të skemave tradicionale standarde të mësimdhënies klasike. Kjo formë e të organizuarit të mësimdhënies së gjuhës së huaj ndikon fuqishëm në fleksibilitetin e vërtetë të orës së mësimimit duke krijuar liri për mësuesin dhe nxënësin.

4- Afron metodologjinë e vlerësimit me kërkesat e Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët, duke afruar kështu më shumë standardet tona të vlerësimit me ato të vendeve evropiane.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në shkollën tonë është karakterizuar shpesh nga një tradicionalizëm i theksuar, forma të ngurta të vlerësimit, larg interesave të vërteta të formimit në gjuhë të huaj. Ndërkohë, programet lëndore me bazë objektivat mësimore do të krijojnë mundësinë që vlerësimi i arritjeve të nxënësve të bëhet sipas objektivave të Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët.

1.2 Aftësitë bazë dhe mësimdhënia e mësim-nxënia në gjuhë të huaj

Kurrikula bërthamë e gjimnazit vendos si detyrim të formimit në gjuhë të huaj zhvillimin tek nxënësit të aftësive bazë si më poshtë:

- Aftësia e komunikimit me shkrim dhe me gojë
- Aftësia e përpunimit dhe përdorimit të informacionit
- Aftësia e të menduarit kritik
- Aftësia e të menduarit krijues
- Aftësia e zgjidhjes së problemit
- Aftësia e qëndrimit etik e social
- Aftësia e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit(TIK-ut)
- Aftësia e punës në grup

Programi i gjuhës së huaj të gjimnazit krahas zhvillimit të aftësive specifike të fushës/lëndës si p.sh aftësive të dëgjuarit, të lexuarit, të shprehurit me shkrim dhe me gojë, aftësive të punës me dokumente tekstual pamorë dhe zazorë, kontribuon në zhvillimin tek nxënësit të aftësive bazë të cituara më sipër. Kështu në mbarim të klasës së dymbëdhjetë nxënësi duhet:

Në mbarim të klasës së 12 nxënës/i-ja duhet:

- ✓ të analizojë, të vlerësojë, të përpunojë, të përzgjedhë, të ruajë, të interpretojë, të këmbëjë, të miratojë dhe të prezantojë informacionin / mesazhin e kërkuar ose të dhënë;
- ✓ të ndjekë, të kuptojë thelbin dhe detajet e bisedës;
- ✓ të bëjë të qartë lidhjet shkak pasojë në një situatë të dhënë;
- ✓ të shprehë pikëpamjet mbi një argument, duke e mbështetur me fakte dhe të dhëna;
- ✓ të krahasojë zgjidhje të ndryshme;
- ✓ të shpjegojë dhe të justifikojë zgjidhjen e parashtruar të një problemi;
- ✓ të bëjë dallimin mes fakteve dhe interpretimit të tyre;
- ✓ të klasifikojë pikat e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të një diskutimi;
- ✓ të diskutojë rreth argumenteve pro dhe kundër;
- ✓ të debatojë për të mbrojtur argumentet dhe qëndrimin e tij / saj ndaj një teze apo ideje.
- ✓ të hartojë një tekst argumentues duke respektuar rregullat strukturore;
- ✓ Të përballojë situata të ndryshme që mund të simulojnë orientimin, shprehjen në gjuhë të huaj gjatë një takimi, udhëtimi në vendin apo krahinën ku flitet gjuha e huaj.
- ✓ Të përdorë në mënyrë mjaft të saktë një repertor strukturash dhe “skemash gjuhësore” të përdorimit të përditshëm në situata të parashikueshme.

Zhvillimi i këtyre aftësive bazë në formimin gjuhësor, ne përputhje me kurrikulën bërthamë të gjimnazit kërkon zhvillimin e mjaft aftësive të domosdoshme në formimin e përgjithshëm, aftësi këto të lidhura ngushtë me procesin e të nxëniet të cilat mund t'i klasifikojmë si me poshtë:

Aftësi të mendimit kritik

Duke qenë se gjuha e huaj është një lëndë ku nxënësi më shumë se kudo tjetër mund të ndeshet me ide, situata dhe fenomene të huaja për botën që e rrethon, prandaj për të nxitur zhvillimin e aftësive të mendimit kritik nxënësit i mundësohet:

- Të kërkojë përgjigje për pyetjet e shtruara në tekst duke mundësuar kërkime për çështje të ndryshme;
- Të mbledhë të dhëna, t'i analizojë, interpretojnë dhe vlerësojë ato duke nxjerrë përfundime individuale.
- Të vendoset para situatave të reja të debatit, gjithnjë e më sfiduese duke realizuar kështu një mendim kritik, si dhe një mësim aktiv të gjuhës së huaj.

Aftësi të mendimit krijues

Gjuha e huaj si lëndë e vë nxënësin në situata të ndryshme, shpesh herw dhe të parashikuara më parë. Është detyrë e shkollës që të zhvillojë te nxënësi mendimin krijues rreth ideve të shprehura në tekst apo çdo dokument tjetër burimor. Kështu nxënësi duhet:

- Të zgjidhë situata të ndryshme problemore që lidhen me përdorimin në rrugë krijuese të njohurive dhe aftësive të tij;
- Të përdorë dhe adoptojë njohuritë dhe aftësitë e përvetësuara në kontekste të reja dhe të ndryshme nga ato të trajtuara në tekste apo burime të tjera informacioni.

Aftësi të punës në grup

Objektivat e gjuhës së huaj, dokumentet burimorë, simulimi i situatave të ndryshme kërkojnë nxitjen e zhvillimin e aftësive të punës në grup. Për të realizuar këtë nxënësit duhet:

- Të punojnë në grup për të kryer, kërkime në burime të ndryshme informacioni për një temë, problematikë apo personalitet të caktuar.
- Të organizojnë punën kërkimore apo çdo lloj pune tjetër duke përcaktuar qartë detyrat e secilit në grup dhe kombinuar nxënësit e niveleve të ndryshme duke kërkuar nxitjen e stimulimin e grupit në përgjithësi dhe çdo nxënësi në veçanti.
- Të raportojnë punën në grup duke nxjerrë në pah realizimin e kërkesave të caktuara më parë pa neglizhuar punën dhe kontributin e secilit.
- Të sigurojnë vlerësime për punën e bërë, të marrin në konsideratë idetë e ndryshme dhe reflektojnë ndaj tyre duke zhvilluar konfidencën në arritjen e qëllimeve të identifikuara.

Aftësi të qëndrimit etik e social

Gjuha e huaj e vendos nxënësin në situata të veçanta shpeshherë sfiduese në aspektin socio-kulturor. Për pasojë, për të formuar, për të nxitur zhvillimin e aftësive të qëndrimit etik e social, nxënësve u mundësohet:

- Të zotërojnë ligjërimin në gjuhë të huaj duke respektuar, normat dhe rregullat e sjelljes shoqërore, respektin ndaj seksit, moshës, detyrës etj.
- Të reflektojnë ndaj vërejtjeve të tjerëve për të përmirësuar performancën e tyre në nivelin socio – kulturor dhe gjuhësor.
- Të dëgjojnë për të kuptuar dhe vlerësuar veten dhe të tjerët.
- Të respektojnë dhe t'u përgjigjen kërkesave të përcaktuara në grup duke u përpjekur për realizimin e tyre.

Aftësi të komunikimit

Komunikimi me shkrim dhe me gojë si një nga objektivat kryesore të kurrikulës bërthamë në shkollë u mundëson nxënësve:

- Të komunikojnë me gojë dhe me shkrim, me një fare sigurie mbi tema të njohura e të panjohura, informacione, ide, ndjenja në mënyrë të qartë duke përdorur një fjali të thjeshtë dhe të strukturuar drejt.
- Të arrijnë të nxitin, të mbajnë ndezur komunikimin, duke shprehur opinione, mendime për çështje të ndryshme duke përdorur një fjalor të saktë apo në rast nevojë të bëjnë dhe perifrime për të shprehur mendimin dhe idenë e dëshiruar.

Aftësi të përdorimit të TIK-ut

Mësimi i gjuhës së huaj lidhet ngushtë me komunikimin me mjedise dhe kultura shpeshherë të largëta, të panjohura për nxënësit, kështu përdorimi i TIK nxit nxënësit:

- Të përdorin TIK-un për të kërkuar dhe menaxhuar informacione që lidhen me tematikat e studiuara, debatuar në klasë.
- Për të realizuar komunikime, kontakte e këmbime në fushën socio-kulturore me bashkëmoshatarë kudo në botë.
- Të realizojnë projekte dhe veprimtari të larmishme në fushën e mësimi të gjuhës së huaj duke bërë të mundur një bashkëpunim, lokal rajonal dhe më gjerë.

Shembull

Pjesëmarrje në veprimtarinë e javës së anglofonisë, frankofonisë etj., në shkallë lokale, kombëtare a më gjerë¹.

¹ Ky shembull do të ilustron në shtojcën 1 të këtij dokumenti.

1.3 Fusha dhe përmbajtja

Roli i gjuhës së huaj në kurrikulën shkollore lidhet me studimin formimin gjuhësor të nxënësve formim i cili ndikon fuqishëm në formimin e tij kulturor. Krahas shkencave ajo informon nxënësit për kulturat, traditat në botën që i rrethon duke i ndërgjegjësuar për vlerat e kulturës dhe traditës kombëtare.

Gjuha e huaj është një nga lëndët që ballafaqon nxënësin me arritjet, njohuritë e tij në mënyrën më të thjeshtë dhe më reale, dëgjimi i një kënge në gjuhë të huaj, pëshpëritja e teksteve të kësaj kënge, hiteve, vështrimi i një filmi në ekranin e vogël apo atë të gjerë janë teste reale të asaj çfarë dhe si është mësuar dhe punuar gjuha e huaj në shkollë, sa dhe si janë arritur objektivat e të nxënësve të gjuhës së huaj. Pikërisht ky aspekt praktik i gjuhës së huaj është konsideruar në kurrikulën e re të gjimnazit në vështrimin e asaj që çdo dokument, çdo njohuri e re e dhënë në orën e mësimit të shndërrohet në një aftësi nga ana e nxënësit.

Mësimi i gjuhës së huaj luan një rol të rëndësishëm për informimin e nxënësve, brezit të së ardhmes me njohuritë, dijet më të përparuara në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Duke zhvilluar kërkimin, debatin dhe mendimin kritik zhvillojmë te nxënësit qëndrime të reja moderne përball aktualitetit, mjedisit, botës që na rrethon.

Kurrikulat e gjuhës së huaj ndërvepron me kurrikulën e fushave të tjera si ato sociale, shkencore duke kontribuar mbi njëra-tjetrën.

Kurrikulat e gjuhës së huaj në gjimnaz, ndërtohet mbi bazën e standardeve të gjuhës së huaj për AML.

Standardet unifikojnë kërkesat e përbashkëta për zhvillimin e kurrikulave lëndore përkatëse në lidhje me zbatimin e rrugës shkencore të njohjes në mësimdhënien-mësim-nxënien e gjuhës së huaj, lidhjen e mësimit të gjuhës së huaj me jetën e gjallë personale dhe shoqërore.

Programi i gjuhës së huaj për gjimnazin, zberthen këto standarde në kërkesa lëndore duke mos harruar për asnjë çast kërkesat e Kuadrit

Evropian të Referencave për Gjuhët si dhe perspektivën evropiane të arsimimit dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Kështu, në programin e ri të gjuhës së huaj për gjimnazin janë karakteristike: kërkimet e nxënësve në fusha të caktuara të interesit kolektiv dhe personal, interpretimet dhe shpjegimi i dukurive përmes përvojave dhe praktikave të ndryshme, përpunimi i të dhënave, përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit për të këmbyer ide, mendime dhe shqyrtuar konkluzione nisur nga problematika dhe perspektiva të ndryshme.

1.4. Mundësitë kurrikulare për integrimin e gjuhës së huaj me lëndët dhe fushat e tjera

Domosdoshmëria për të krijuar një formim të përgjithshëm ku formimi në lëndë të ndryshme të ketë influencë dhe kontribut në formimin e lëndëve dhe fushave të veçanta konsiderohet sot integrim kurrikular ose ndërveprim ndërlëndor.

Pikërisht ky ndërveprim ndërlëndor lehtëson përpjekjet e nxënësve në arritjet e objektivave në fusha dhe lëndë të ndryshme. Sigurisht në mënyrë logjike dhe të natyrshme pa sforcime mësimi i gjuhës huaj mund të integrohet në mësimin e lëndëve të fushës shoqërore por dhe të fushave të tjera kurrikulare si ato shkencore etj.

Nxënësve duhet t'u ofrohen mundësitë e mëposhtme që janë pjesë integrale e nxënies së tyre dhe që lehtësojnë zotërimin nga ana e tyre e koncepteve, proceseve dhe përmbajtjes së lëndës.

1.4.1. Ndërveprimi midis vete gjuhëve të huaja

a) Integrimi i koncepteve dhe parimeve të përgjithshme gjuhësore

Është shumë e rëndësishme dhe lehtësuese për nxënësin që mësuesi

të përdorë njohuri dhe koncepte të gjuhës amtare për të sqaruar dhe ndërtuar aftësi të nxënësit në gjuhë të huaj. Kështu përdorimi i rendit të fjalëve në fjali, **Kryefjalë – folje – kundrinorë (kundrinorët e drejtë dhe të zhdrejtë) / përcaktorë** (në gjuhën shqipe) përkon (por jo gjithnjë) me rendin e fjalëve në fjali në gjuhën huaj.

b) *Integrimi në metodë.*

Për të ndihmuar përvetësimin logjik të fjalorit, për të fiksuar një strukturë të veçantë foljore: p.sh foljet e zgjedhimit të parë në gjuhën frënge i drejtohem i etimologjisë, gjuhës latine ose më mirë të themi njohurive të nxënësve në gjuhën italiane, pasardhëse direkt e gjuhës latine: kështu shpjegojmë që të gjitha foljet që në italisht mbarojnë me mbaresën ***are si cantare mangare*** në gjuhën frënge janë folje të grupit të parë. Ky shpjegim ndihmon në përvetësimin logjik njohurive nga ana e nxënësve të nivelit minimal të nxënësve. Kjo metodë krahasuese mund të ndihmojë në krijimin e koncepteve dhe për kategori e forma të tjera gjuhësore.

1.4.2. Ndërveprimi i gjuhës së huaj me fushat e tjera të nxënies.

Në kurrikulën e re të gjitha fushat e të nxënësve sigurojnë lidhje të shumta ndërvepruese mes tyre. Këto lidhje kanë të bëjnë me transferimin dhe përforsimin e informacioneve dhe aftësive të fushave të tjera gjatë studimit të një fushe të dhënë, apo dhe në trajtimin e temave dhe problemeve të ndryshme që kërkojnë ndërthurjen e shumë fushave të nxënies për t'i studiuar dhe zgjidhur sa më mirë ato.

1.4.3. Integrimi objektivave të përbashkëta ndërmjet lëndëve

Ndërveprimi ndërmjet objektivave të përbashkëta realizohet

kryesisht *me lëndët e fushës shoqërore*, kështu integrimi midis lëndëve si historia, gjeografia, arti, ndeshet në kurrikulën e re ashtu siç ndeshet hap pas hapi në tekstet e metodat e gjuhës së huaj qofshin ato klasike apo bashkëkohore. Kështu kurrikula e re trajton në mësimin e gjuhës së huaj njohjen, informimin mbi ngjarje apo fenomene të botës kulturore, artistike apo historike, fusha këto tepër tërheqëse për interesat e nxënësit.

Integrim objektivash me lëndët e shkencave të natyrës si fizikë, kimi dhe biologji, informatikë. Ndonëse objektivat e këtyre lëndëve janë mjaft shkencore, dhe si pasojë kurrikula i trajton në fusha të veçanta; trajtimi i kërkimit në këto lëndë mbi jetën e personaliteteve shkencore, rrugën e evoluimit të një ligji të veçantë apo arritjeje shkencore, lidhjen me jetën e përditshme, përbëjnë një thellim të njohurive në gjuhë të huaj pasi ky kërkim krahas aftësisë së kërkimit, përpunimit të dijeve të reja, të menduarit kritik, krijon aftësi të reja për shprehjen me shkrim apo me gojë në gjuhë të huaj mbi një fushë të caktuar të shkencës.

1.4.4. Integrimi sipas problemeve

Integrimi sipas problemeve, lidhet me një grup problemesh jetësore si p.sh problemet e mjedisit, të cilat zënë vend të rëndësishëm në kurrikulë dhe në të gjitha tekstet e gjuhës së huaj bashkëkohore, trajtohen në lëndë të tjera si mjedisi, gjeografia, ekonomia, shkencat sociale dhe të shëndetit por kurdoherë secila shkencë studion problemin në fjalë sipas këndvështrimit të saj.

Sekuenca të praktikave pedagogjike të ndërthurjes ndërlëndore (anglisht, italisht e frëngjisht me histori – sociologji – arte mund të shërbejnë për veprimtari të ndryshme për tre nivelet e arritjeve të të nxënës.

Kështu një material burimor, tekst në gjuhë të huaj mund të analizohet dhe studiohet në këndvështrime të ndryshme. Nëse në kurrikulën e gjuhës së huaj prezantohen dokumente të ndryshme si peizazhe turistike, foto apo dokumente shifrore atëherë këto dokumente mund të thellohen

në studimin e tyre duke ndërthurur gjuhën e huaj me shkencën si *gjeografia* ku mund të flasim për vendndodhjen e vendit në fjalë, kufijtë, sistemin organizativ shtetëror etj, *historia* për karakteristikat kryesore të periudhave të historisë së këtij vendi, monumente të rëndësishme si pjesë e trashëgimisë historike etj.

I njëjti proces ndërveprimi mund të shfrytëzohet dhe për të formuar automatizmin e duhur gjuhësor të krahasimit; domethënë për të perfeksionuar përdorimin e shkallës së mbiemrit apo ndajfoljes. Për këtë përdoren elementë grafikë nga lënda e gjeografisë, skema apo të dhëna që jepen në programin dhe tekstin e gjeografisë, kryhen veprime logjike apo matematike që lidhën me fushën e matematikës.

Kurrikula e gjimnazit mundëson integrimin, ndërthurjen ndërlëndore, duke i hapur udhë përvetësimit logjik, aftësimit të natyrshëm të nxënësve me dije të qëndrueshme mbi fenomene, lëndë të veçanta, duke krijuar lidhje mes tyre.

Programet e integruar paraprijnë krijimin e dijeve të unifikuara për fenomene, të caktuara që lidhen me fusha të ndryshme të dijes.

Mësimi i integruar përmes ndërthurjes ndërlëndore mundëson sintetizimin e njohurive në një aspekt të caktuar, mundëson perceptimin e zgjidhjen praktike të situatave të ndryshme në jetën praktike.

Mësimi i integruar bëhet nxitës për nxënës me prirje drejt lëndëve të veçanta, duke u krijuar atyre mundësinë e të shprehurit në gjuhë të huaj për probleme që ato shfaqin interes.

Mësimi i integruar nxit, motivon nxënësin në kërkim, grumbullim faktesh e njohurish, forcon individualitetin dhe kolegjalitetin në kërkim, për të arritur realizimin e objektivave mësimorë.

Pjesëmarrja në projektet mësimore është shfaqja më cilësore e mësimin të integruar, ku krahas punës në grup, mes individësh dhe grupesh të veçantë, thellohen dhe konsolidohen njohuritë dhe aftësitë në fusha të ndryshme të dijes.

1.5 Klasifikimi i objektivave të arritjes sipas Blumit

Objektivat e arritjes në gjuhë të huaj për klasën e 10-të dhe 12-të

Tre nivelet	Nivelet e Blumit	Foljet përshkruese
Niveli bazë	<p>1. Të njohurit: Konsiderohet riprodhimi i diçkaje pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritje e emrave, rregullave, përkufizimeve dhe shpjegimeve ashtu siç janë dhënë. Është niveli më i ulët i rezultateve të nxënësve në fushën njohjes.</p>	Përkufizo, përsërit, përshkruaj me fjalët e tua, identifikoj, vër në tabelë, listoj, emërtoj, riprodho etj.
	<p>2. Të kuptuarit: Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit. Është baza e fushës së njohjes, një hap më tej se të njohurit.</p>	Shpjego, zgjero, jep shembuj të tjerë, nxirr përfundime, perifrizzo, rishkruaj, përgjithëso, interpretoj ndryshe, nxirr një përfundim etj.
Niveli mesatar	<p>3. Aplikimi: Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje dhe teori.</p>	Apliko, (zbato), shfrytëzo, ndrysho, njehso, klasifikoj, provo, vër në dukje, manipuloj, përgatit, lidh, tregoj, shpjego, përdor etj.
	<p>4. Analiza: Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse, çka sjell një kuptim më të mirë të organizimit të tij. Meqenëse krahas përmbajtjes kuptohet edhe forma organizative e materialit, niveli intelektual është më i lartë se në të kuptuarit.</p>	Copëtoj, ndaj në pjesë, shpjego përse, diferencoj, shquaj, dallo, vër në dukje, lidh, përzgjidh etj.

Niveli i lartë	<p>5.Sinteza: Është aftësia që formon një të tërë, duke bashkuar pjesët. Mund të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ komunikim i një plani veprimesh, ✓ klasifikim informacioni etj 	Kombino, harto, krijo, zgjidh (një problem që ka shumë rrugë), kompoz, jep mendime, përmirëso, organizo, planifiko, ri-sistemo, shkruaj, trego, prodho, harto, transmeto, krijo, propoz, planifiko, prodho, modifiko, specifiko, kombino, organizo, sintetizo, klasifiko, përfundo, zhvillo, modifiko, ndërto etj.
	<p>6.Vlerësimi: Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve, vlerësimin e zgjidhjeve të problemit, ndërtimi i komunikimeve gjykuese etj.</p>	Krahaso, konkludo, vër në kontrast, kritiko, përshkruaj, shpjego, justifiko, interpreto, lidh, përmblihdh, bëj një evidencë, etj.

Objektivat e arritjes, të shënuara në program janë për të gjithë nxënësit. Të gjithë nxënësit duhet të arrijnë objektivat e programit, por është e natyrshme që cilësia e arritjes së objektivave të programit nuk është e njëjtë nga të gjithë nxënësit. I takon mësuesit të vlerësojë arritjet e nxënësve dhe të formulojë objektiva sipas niveleve të të nxënimit në përshtatje të objektivave të përcaktuara në programin e miratuar.

**Objektivat e Arritjeve të të nxënit sipas Blumit ndahen në tre grupe:
Objektivat e arritjes të kurrikulës bërthamë**

Tre nivelet		Objektivat e arritjes
Niveli bazë	<p>1. Të njohurit: Konsiderohet riprodhimi i një diçkaje pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritje e emrave, rregullave, përkufizimeve dhe shpjegimeve ashtu siç janë dhënë. Është niveli më i ulët i rezultateve të nxënësve.</p> <p>2. Të kuptuarit: Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit. Është baza e fushës së njohjes, një hap më tej se të njohurit .</p>	<p>Të dallojë lehtësisht thelbin e dokumenteve burimorë, teksteve të shkruara, programeve radiofonike dhe televizive që trajtojnë temave të njohura e të panjohura prej tij me kusht që ato të jenë shprehur qartë me një gjuhë të strukturuar mire dhe të shqiptuar me një ritëm normal. Të shprehet saktë me gojë dhe me shkrim mbi çështje të interesit vetjak.</p>
Niveli mesatar	<p>3. Aplikimi: Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje dhe teori.</p> <p>4. Analiza: Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse, çka sjell një kuptim më të mirë të organizimit të tij. Meqenëse krahas përmbajtjes kuptohet edhe forma organizative e materialit, niveli intelektual është më i lartë se të të kuptuarit.</p>	<p>Të ndjekë një ligjëratë të shqiptuar qartë, të përzgjedhë informacionin e kërkuar dhe identifikojë pikat kryesore të një dokumenti apo diskutimi mbi tema të njohura e të panjohura. Të shprehet me gojë dhe me shkrim duke përdorur regjistrin e përshtatshëm dhe fjalor të larmishëm mbi ngjarje të vërteta ose imagjinare duke motivuar arsyet dhe preferencat e tij.</p>

Niveli i lartë	<p>5.Sinteza: Është aftësia që formon një të tërë duke bashkuar pjesët përbërëse të saj. Mund të jetë: komunikim i një plani veprimesh, klasifikim informacioni etj.</p> <p>6.Vlerësimi: Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve, vlerësimin e zgjidhjeve të problemit, ndërtimi i komunikimeve gjykuese etj.</p>	<p>Të kuptojë materialin e regjistruar dhe të shkruar duke reflektuar dhe zhvilluar aftësinë interpretuese mbi përmbajtjen e tij.</p> <p>Të raportojë qartë me gojë e me shkrim mbi ambiciet, planet apo pwrvojat e tij duke parashtruar arsye dhe shpjegime përkatëse.</p>
-----------------------	--	---

1.6. Objektivat specifike të arritjes në gjuhë të huaj

(kurrikula bërthamë, klasa 10-të - 12-të)

Kurrikula e re kërkon që standardet të bazohen në objektivat e arritjeve të nxënësit. Në gjimnaz si në gjithë sistemin tonë parauniversitar klasifikojnë 3 nivele arritjeje të objektivave të arritjes nga nxënësit: **niveli bazë, niveli mesatar, niveli i lartë.**

Për secilin objektiv arritjeje të programit mësuesi duhet të përcaktojë objektivat specifike të arritjes, **të rrjedhura nga objektivi i programit:** për nivelin bazë, nivelin mesatar, nivelin e lartë.

Kuptohet **niveli i lartë i arritjes** ka objektiv specifik vetë objektivin e programit, **objektivi specifik në nivelin bazë** përshkruan një arritje të pjesshme të kufizuar të objektivit të programit dhe **objektivi specifik i nivelit të mesëm** përshkruan një arritje afër objektivit të programit.

Në vijim përshkruajmë shembuj të zërthimit të objektivave të programit (*objektiva të njohjes e të kuptuarit, objektiva të zbatimit dhe analizës, objektiva të sintezës dhe vlerësimit*) në objektiva specifike të 3 niveleve të arritjes.

Niveli bazë:

Të dëgjuarit:

- ✓ Të identifikojë qëndrimet e folësve në diskutime për tema të njohura lidhur me shkollën, familjen dhe kohën e lirë, kur gjuha është e qartë dhe standarde.
- ✓ Të dallojë dhe të kuptojë me pak vështirësi thelbin e programeve televizive dhe disa të dhëna faktike për tema të njohura;

Të lexuarit:

- ✓ Të formojë një kuptim të përgjithshëm mbi bazën e asaj që ka lexuar.
- ✓ Të identifikojë pjesërisht informacionin e detajuar të shprehur në shifra apo emra konkretë.

Të folurit:

- ✓ Të zhvillojë me lehtësi e pa përgatitje një bisedë të drejtpërdrejtë për tema të njohura si, p.sh., familja, shokët, shkolla e koha e lirë dhe të shkëmbejë informacionin e nevojshëm rreth tyre.
- ✓ Të kërkojë dhe të transmetojë informacionin e nevojshëm, duke kërkuar dhe ndjekur udhëzimet përkatëse duke respektuar rregullat e mirësjelljes.

Të shkruarit:

- ✓ Të përshkruajë përmbledhtas dëshirat, ëndrrat, ambiciet dhe planet për të ardhmen;
- ✓ Të kërkojë dhe të transmetojë përmes mediave elektronike informacionin e nevojshëm.

Niveli mesëm:

Të dëgjuarit:

- ✓ Të ndjekë pa vështirësi një ligjëratë të shqiptuar qartë, që i drejtohet atij/asaj në një bisedë të përditshme, me ndihmën e përsëritjes së disa fjalëve e shprehjeve.
- ✓ Të ndjekë pikat kryesore të një diskutimi relativisht të gjatë, me kusht që shqiptimi të jetë i qartë.
- ✓ Të ndjekë rrjedhën e një filmi, në të cilin subjekti mbështetet te veprimet dhe figurat.

Të lexuarit:

- ✓ Të nxjerrë dhe të përzgjedhë informacionin e duhur të një dokumenti.
- ✓ Të identifikojë idenë kryesore nga një material i dhënë në gjuhë standarde dhe me leksik pak a shumë të pasur;
- ✓ Të lidhë informacionin e një dokumenti me një informacion të jashtëm;

Të folurit:

- ✓ Të marrë pjesë në diskutime për tema të njohura, me një siguri të kënaqshme, shpesh duke riformuluar mendimin e tij;
- ✓ Të tregojë përmbajtjen e një libri apo filmi, të japë mendime e të përshkruajë përshtypjet e tij;
- ✓ Të shprehë me mirësjellje bindjet dhe opinionet e tij, nëse është dakord ose jo dhe të mirëpresë ato mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve;
- ✓ Të shprehet rrjedhshëm, me një fjalor të larmishëm dhe me një shqiptim të mirë e përgjithësisht të saktë, për tema të

përditshme, si shkolla, udhëtimet etj;

- ✓ Të shprehë e të kërkojë mendimin personal në diskutime me shokët, për tema të interesit të përbashkët;

Të shkruarit:

- ✓ Të shkruajë qartë e të strukturojë mirë, ide, mendime për tema të interesit vetjak dhe asaj çka e rrethon në jetën e përditshme.
- ✓ Të përshkruajë një ngjarje të vërtetë apo imagjinare, me fjalor të përshtatshëm për shkrimet treguese;
- ✓ Të përshkruajë thjesht e saktë përmbajtjen e një libri ose filmi, duke dhënë mendimin e tij vetjak;
- ✓ Të shkruajë letra rreth përvojave të veta, duke motivuar ndjenjat si: gëzim, trishtim, habi, keqardhje etj;

Niveli i lartë/ i avancuar /përformancë e jashtëzakonshme

Të dëgjuarit:

- ✓ Të kuptojë në detaje një ligjërime në gjuhë standarde, edhe pse në një ambient të zhurmshëm.
- ✓ Të aftësohet të kuptojë idetë kryesore të një ligjërimi të ndërlikuar nga pikëpamja e brendisë dhe formës, mbi një temë konkrete ose abstrakte.

Të lexuarit:

- ✓ Të reflektojë mbi përmbajtjen e një teksti, të vlerësojë se sa me vend janë elemente të veçanta të informacionit;
- ✓ Të formulojë një përfundim logjik për atë që ka lexuar duke përdorur një informacion të njëjtë më atë që i jepet në klasë dhe të bëjë të mundur identifikimin dhe paraqitjen e elementeve provuese;
- ✓ Të reflektojë për një dokument, bazuar mbi disa vlera dhe

bindje personale;

- ✓ Të japë një gjykim në lidhje me moralin e një historie.

Të folurit:

- ✓ Të përshkruajë planet, projektet dhe ambiciet e tij, duke dhënë arsye e shpjegime;
- ✓ Të përshkruajë me hollësi një ngjarje të vërtetë dhe të shprehë qartë përshtypjet për të;
- ✓ Të shprehë pikëpamjet vetjake për zgjidhjet e një problemi dhe të ftojë të tjerët që të marrin pjesë në debat;
- ✓ Të kërkojë e të japë sqarime në situata të paparashikuara;
- ✓ Të krahasojë ose të vërë përballë alternativa, duke theksuar çështjet më të rëndësishme të problemit;
- ✓ Të kuptojë në detaje dhe të marrë pjesë pa ndrojtje në biseda të zgjeruara për çështje të përgjithshme edhe në mjedise të zhurmshme.
- ✓ Të mbështetë mendimet e tij / saj në diskutime, duke dhënë shpjegimet, argumentet dhe komentet e duhura.
- ✓ Të përballojë një debat duke identifikuar qartë argumentet në mbështetje apo kundër pikëpamjes së tij / saj.

Të shkruarit:

- ✓ Të kërkojë me shkrim informacionin e duhur për shërbime të ndryshme, duke paraqitur kërkesat e tij specifike për këtë shërbim;
- ✓ Të shkruajë raporte të shkurtra rreth një situatë të caktuar, duke parashtruar mendimet e tij pro dhe kundër;
- ✓ Të shtjellojë një argument, në një ese apo raport, duke theksuar pikat kyçe dhe përfshirë në të detajet mbështetës.
- ✓ Të vlerësojë me shkrim, ide dhe zgjidhje të ndryshme për një problem, duke shpjeguar qartë avantazhet apo disavantazhet e varianteve të ndryshëm

2. Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës

Mësimdhënia e gjuhës së huaj bazohet në punën e organizuar në klasën e gjuhës së huaj mbi disa dokumente burimore, të cilat ndryshojnë nga natyra, nga fusha e interesit, origjina e tyre. Pikërisht vetë larmia e këtyre dokumenteve burimore, si dhe larmia e aftësive që ndërton mësimdhënia e gjuhës së huaj, mundësojnë përdorimin e metodave dhe procedurave metodologjike të larmishme në orën e mësimit.

Dekada më parë pedagogjia vendoste mësuesin në qendër të edukimit por sot me zhvillimet e mëdha që ka pësuar shoqëria në të gjitha fushat dhe edukimi në veçanti, vendos nxënësin në qendër të edukimit të tij. Gjuha e huaj duke qenë një lëndë që vendos nxënësin para shumë të panjohurash gjuhësore dhe jo vetëm, lind nevoja që në momente të veçanta të orës së mësimit të bëhet gërshetimi i teknikave të veçanta të mësimdhënies pa kaluar në teprime, duke synuar gjithmonë objektiva të qarta të arritjeve.

Gërshetimi i teknikave të metodës tradicionale me teknikat moderne bashkëkohore ndikon në gjallërimin e variacionin e orës së mësimit, por mbi të gjitha ndikon në arritjen e objektivave të nxënit. Përvetësimi i njohurive në gjuhë të huaj kërkon kombinim të teknikave dhe procedurave për të rritur efektivitetin e orës së mësimit. Vënia e nxënësit në qendër të edukimit nuk përjashton rolin e mësuesit drejtues në momente të veçanta të procesit të mësimdhënies, kështu kombinimi i teknikave në vartësi të objektivave të arritjeve del si detyrë parësore për zbatimin me efikasitet të mësimdhënies.

Teknika të Metodës Tradicionale që gërshetohen në procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj.

Kallëzimi:

Kallëzimi është një metodë në esencë të cilës është tregimi dhe përshkrimi i materialit të paraqitur në dokumentin burimor. Kjo metodë përdoret kur materiali burimor nuk është i vështirë dhe mësuesi jep detaje plotësuese për të tërhequr interesin e nxënësve, detaje këto të njohura nga nxënësi dhe që i japin interes dhe vlerë emocionale materialit burimor. Kallëzimi duhet të karakterizohet nga thjeshtësia dhe bukuria e fjalës nga emocionet që ngjall ligjërimi gjatë kësaj teknike.

Biseda:

Biseda tradicionalisht është konsideruar si dialog mes mësuesit dhe nxënësve. Ajo u krijon nxënësve shumë hapësirë për të diskutuar dhe debatuar në klasë për çështje të shtruara në mësim, nxit interesin dhe mendimin e tyre, i aktivizon ato duke u dhënë mundësi të shprehin mendimet e tyre në mënyrë individuale. Biseda kombinohet me teknika si shpjegimi, krahasimi etj.

Për të organizuar një bisedë të suksesshme është e rëndësishme të shtrohet qartësisht problemi dhe të jenë të qarta objektivat e arritjeve sipas niveleve në organizimin e bisedës, duke e ngritur atë mbi objektiva të qarta sipas niveleve të të nxënit.

Theksojmë se:

- ✓ Biseda nuk mund të organizohet në nivele minimale të arritjeve.
- ✓ Biseda duhet të organizohet për tema apo çështje që tërheqin masën e nxënësve.
- ✓ Biseda s' duhet të ketë në qendër të saj një apo disa nxënës që aktivizohen përherë, por ajo duhet të organizohet për të interesuar

masën e nxënësve në klasë.

- ✓ Biseda duhet t'i shërbejë arritjes së objektivave të përcaktuara nga mësuesi.
- ✓ Biseda duhet t'i shërbejë kuptimit të mëtejshëm të problemit, thellimit, si dhe reflektimit ndaj tij.

Shpjegimi:

Shpjegimi do të thotë zërbërthim analitik, argumentim për të nxjerrë kuptimin dhe arritje në përfundime përkatëse për një objekt, dukuri apo fenomen duke krijuar bindje të shëndosha dhe të qëndrueshme të të nxënësve.

- ✓ Shpjegimi përdoret nga mësuesi për të paraqitur lëndën e re, për të shpjeguar, qartësuar diçka që nuk kuptohet nga nxënësit.
- ✓ Shpjegimi shpesh herë barazohet me dhënien e informacionit, koncept ky tashmë arkaik dhe pak i përdorur.
- ✓ Shpjegim do të thotë përgjigje pyetjeve e problemeve të paqarta që dalin në kontaktin me dokumentet burimorë.
- ✓ Shpjegimi nuk është “në pronësi” të mësuesit, përkundrazi marrja pjesë e nxënësve në shpjegimin e materialit të lëndës së re, paraqitja e këtij materiali të shpjeguar nga diskutimi i nxënësve bën më efikas shpjegimin .
- ✓ Shpjegimi nuk mund të bëhet i shkëputur nga mjetet e tjera didaktike.

Përkthimi:

Përkthimi është një teknikë që ndihmon mësuesin dhe nxënësin për shpjegimin e një koncepti. Përkthim do të thotë të kthesh në një gjuhë tjetër një fjalë apo grup fjalësh nga gjuha e huaj në gjuhën amtare ose e kundërta, pa ndryshuar kuptimin, duke e ruajtur plotësisht dhe nuancat e saj.

Është e rëndësishme të theksojmë që përkthimi duhet përdorur si teknikë shtesë e kombinuar me metodat e tjera duke synuar metodën me nxënësin në qendër që sigurojnë mësim aktiv të gjuhës së huaj.

Krahasimi:

Krahasimi është një metodë që konsiston në vënien përballë të dy anëve të një objekti, dukurie apo dukurive të ndryshme. Në mësimin e gjuhës huaj krahasimi si teknikë gjuhësore që ballafaqon përballë njëra-tjetrës dy struktura paralele, kontribuon në krijimin e automatizmave gjuhësore.

Teknika të Metodës Bashkëkohore që gërshetohen në procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj

Progresi i pedagogjisë ka sjellë zhvillim dhe përparim në fushën e metodës dhe teknikave të mësimdhënies. Kështu për arritjen e objektivave, dhe krijimin e aftësive të qëndrueshme të nxënit në gjuhë të huaj, siç e parashtruam dhe më sipër kërkohet një gërshetim i teknikave të mësimdhënies, gërshetim i të ashtuquajturave teknika tradicionale me ato bashkëkohore për të synuar rritjen e nivelit të aftësive të nxënësve në të gjithë komponentët e gjuhës së huaj.

Le të shohim më poshtë cilat janë disa nga teknikat bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës së huaj.

Esenca e përmbajtjes së këtyre metodave është **të mësuarit në bashkëpunim**. Të mësuarit në bashkëpunim mundëson punën me grupe ku bazë janë përveç këmbimit informacionit, diskutimit i ideve, kuptimi dhe zgjidhje për problemin e shtruar.

Pedagogjia e diferencuar

Pikërisht **Pedagogjia e diferencuar** në klasën e gjuhës së huaj luan një rol të rëndësishëm për përvetësimin e njohurive. Aftësimi i nxënësve në këtë fushë i përgjigjet objektivave të demokratizimit të mësimin. Teknikat e pedagogjisë së diferencuar i përgjigjen dallimeve në mes profileve të nxënësve, ritmeve të të nxënit, interesave dhe pasioneve të nxënësve të veçantë.

Çfarë dhe si duhet të diferencojmë:

Format e diferencimit të brendshëm të lidhura me organizimin, administrimin e brendshëm në shkollë, organizimin e mësimit, ambientit dhe mbi të gjitha përmbajtjen dhe objektivat.

Format e diferencimit të jashtëm bazohen në karakteristikat e vetë nxënësve, nivelin, interesat dhe pasionet e tyre. Është pikërisht mbi këtë bazë që mësuesit ngrenë strategjitë e mësimdhënies.

Hapa që duhen ndërmarrë për të aplikuar pedagogjinë e diferencuar:

- ✓ Përcaktimi i saktë i niveli të njohurive të nxënësve,
- ✓ Vlerësim i detajuar i kapaciteteve e interesave të nxënësve,
- ✓ Vlerësim i çdo arritjeje e përparimi nga ana e nxënësve.

Çfarë dhe si duhet diferencuar?

- ✓ Diferencim i situatave dhe i kushteve të punës;
- ✓ Organizim i ndërveprimit të veprimtarisë, aktiviteteve kolektive me ato individuale duke marrë në konsideratë karakteristikat individuale të nxënësit;
- ✓ Organizim pune paralele sipas nivelit të njohurive duke u përpjekur për aktivizimin e çdo nxënësi;
- ✓ Pjesëmarrje e çdo nxënësi në grupe të ndryshme të paraqitjes;
- ✓ Variacion i dimensionit në hapësirë dhe kohë, duke ndryshuar raportet e kohës së shfrytëzuar në mësim për etapat e ndryshme të nxënësve, aktivitetet praktike, komentet e dokumenteve burimorë të shkruar që kanë lidhje me temën e trajtuar .
- ✓ Ndryshim të mjedisit mësimor: klasë, sallë multimediale, muze, dalje në mjedise të ndryshme në përshtatje me temën e trajtuar,

Diferencimi i Objektivave të mësimdhënies.

Diferencimi i objektivave të mësimdhënies kërkon së pari të alternohen objektivat të përgjithshëm dhe ato specifike.

Është e rëndësishme të imponohet një logjikë pune që u kërkon nxënësve adaptimin ndaj një situatë të dhënë që imponon një ritëm dhe kohëzgjatje të caktuar në orën e mësimit.

Nxënësi duhet të adaptohet natyrshëm me një mësimdhënie ku të ndjehet i qetë, dhe i mirë-vlerësuar larg përjashtimit në çfarëdo situatë të procesit mësimor dhe edukativ. Për të ndihmuar përvetësimin e objektivit të orës së mësimit, mësuesi përdor sipas nivelit të nxënësve veprimtari e teknika të ndryshme. Për të mundësuar këtë aspekt mësuesi duhet të dijë të aplikojë një gamë të pasur veprimtarish të parashikuara që më parë për mësimin si: ushtrime konceptuese, riformuluese, adaptimit, të strukturimit, pyetësor në përshtatje me nivelin dhe interesat e nxënësit.

Shembull: Nëse objektivi i orës së mësimit është të shprehurit me gojë rreth temës

“Unë, Pushimet dhe Turizmi” është e domosdoshme përmbushja e një sërë objektivash specifike të tillë si:

- Rendi i fjalëve në “Fjalinë e thjeshtë dhe atë të përbërë”
- Përshtatja e përcaktorëve me emrin që përcaktojnë.
- Zotërimin e fjalorit të saktë për të shprehur karakteristikat dhe veçoritë për temën në fjalë.
- Shkallët e përdorimit të mbiemrit dhe ndajfoljes në ligjërimin me gojë.

Ky objektivi mundësohet nga vetë baza e kurrikulës së re të shkollës së mesme bazuar në objektiva. Mësimdhënia e gjuhës së huaj si pjesë përbërëse e kësaj kurrikule realizohet ndërmjet objektivave gjuhësorë të domosdoshëm për formimin e dijes, aftësive dhe mundësimin e ndërveprimit ndërkulturor dhe ndër-kurrikular.

Diferencimi i veprimtarive dhe detyrave

Diferencimi i veprimtarive dhe detyrave në mësimin e gjuhës së huaj mund të ndryshojë në funksion të mjaft faktorëve si për shembull: dokumentet burimorë, aftësitë që duam të zhvillojmë, natyra e punës që do të kryejmë me gojë apo me shkrim. Gjithnjë në këtë kuadër mësuesi duhet të fiksojë objektivin e veprimtarisë pedagogjike mbi këtë dokument, do të jetë një veprimtari bashkëvepruese që nxit gjithnjë e më shumë pavarësinë, vetëbesimin e nxënësit duke zhvilluar kapacitetin e nxënësit në aftësitë e të kuptuarit, dhe të shprehurit me shkrim dhe me gojë.

Është shumë e rëndësishme që mësuesi të ndryshojë dokumentet burimorë në funksion të arritjeve të nxënësve, dhe mbi këtë bazë të ndryshojë teknikat pedagogjike për organizimin e veprimtarive në klasën e gjuhës së huaj.

Pedagogjia e diferencuar dhe puna me grupe në mësimin e gjuhës së huaj.

- a. Çfarë përfaqëson grupi në mësimdhënien e gjuhës së huaj?
- b. Si formohet grupi në klasën e gjuhës së huaj?
- c. Veprimtari praktike në mësimin e gjuhës huaj bazuar në punën me grupe.

a. Çfarë përfaqëson grupi në mësimin e gjuhës së huaj?

Të punosh me grupe në mësimin e gjuhës së huaj do të thotë të luftosh indiferencën, të kërkosh një grup aktiv pavarësisht nga nivelet e ndryshme të arritjeve të nxënësve.

Klasa e gjuhës së huaj në vartësi nga numri total i nxënësve, ndahet në grupe me 3-5 nxënës.

Grupet mund të jenë heterogjenë ose homogjenë duke konsideruar arritjet e nxënësve.

Secili grup mund të ketë karakteristikat e tij dhe të gjithë së bashku karakteristika të përbashkëta.

Për grupet homogjene përgatiten detyra, veprimtari që marrin në konsideratë nivelin e dijeve të nxënësve, interesat e tyre. Kështu aktivitete bazuar në një kërkesë më të lartë për nxënësit me nivel të avancuar, më të thjeshta për nivelin e mesëm dhe detyra të thjeshta për grupin e nxënësve që kanë një nivel minimal të arritjeve.

Nxënësit me përparim të avancuar mund të japin gjykimin e tyre mbi një dokument të caktuar, t'u përgjigjen situatave të sintezës, ndërsa ata me nivel minimal të identifikojnë idenë kryesore, linjat e veprimit etj.

b. Si formohet grupi në klasën e gjuhës së huaj?

Grupi mund të organizohet duke u bazuar në:

- a) Dëshirën për të punuar së bashku.
- b) Dëshirën për të punuar mbi të njëjtën temë.
- c) Nivelin gjuhësor dhe shkencor të nxënësve
- d) Interesat dhe pasionin

Secili grup duhet të ofrojë kontributin kolektiv, ku secili nxënës duhet të ndjehet aktiv dhe i përgjegjshëm për paraqitjen e punës kolektive. Grupi duhet të caktojë një raportues që të prezantojë punën e përbashkët. Mund të organizohen grupe të ndryshme për detyra, veprimtari të ndryshme duke synuar objektiva të ndryshme të arritjeve të të nxënësve.

Diagrami i Venit

Kjo teknikë konsiston në ballafaqimin e dy objekteve, dukurive apo fenomeneve me qëllim evidentimin e dukurive të përbashkëta dhe veçantive të tyre. Për këtë ndërtohen dy rrathë që ndërpriten duke u vendosur njeri mbi tjetrin. Në hapësirën e përbashkët të dy rrathëve shënohen anët e përbashkëta, ndërsa në dy pjesët e veçanta shënohen veçoritë individuale të secilit objekt, dukuri apo fenomen.

Është e rëndësishme që krahas detyrës mësuesi të përcaktojë kohën për realizimin e kësaj detyre si dhe kushte të tjera në vartësi të objektivit të synuar ndërmjet kësaj teknike.

Shembull i diagramës së Venit²:

Ditari i të nxënit ose Ditari i dyfishtë

Është një teknikë që i mundëson nxënësit shënimin në fletore për atë çka punohet në mësimin e gjuhës. Sipas kësaj teknike faqja e fletores ndahet vertikalisht në dy pjesë. Në anën e djathtë nxënësi shkruan pjesë nga materiali i dokumentit që e kanë tërhequr më shumë; ide, fjalë që i kanë pëlqyer, nuanca të përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve të përdorura në anën e majtë nxënësi shënon përshtypjet, mendimin e tij, çfarë pyetjesh i dalin rreth dokumentin në fjalë, shembuj të tjerë të përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve të shënuara.

Tabela T³

Kjo teknikë është e lidhur me ekzistencën e një table, ose fletoren e punës ku në dy anët shkruhen argumente pro dhe kundër një ideje të caktuar. Është e rëndësishme që të përcaktohen si për çdo detyrë tjetër kushtet e realizimit të detyrës. Pasi kjo të jetë kryer u lejohet ballafaqimi i argumentimeve brenda një mini-grupi të nxënësve, krahasohen argumentet e nxënësve pro dhe kundër duke listuar secilën nga listë-pohimet pro dhe ato kundër.

Pas kësaj procedure mësuesi mund të nxitë diskutimin, debatin brenda grupeve të nxënësve në diskutim të këtij apo atij argumenti.

² Shembulli I ilustruar gjëndet në shtojcën 2.

³ Shembulli i tabelës ilustron në shtojcën 3.

Rrjeti i diskutimit

Rrjeti i diskutimit në ngjashmëri me teknikën e tabelës T, gjykon argumentet pro dhe kundër një ideje apo mendimi të caktuar. Në këtë rast mësuesi harton një pyetje që kërkon përgjigje pozitive apo thjesht negative. U kërkohet nxënësve të ndarë në dy ose më shumë grupe, të shkruajnë argumentet pro dhe ato kundër, të cilat ballafaqohen në mes tyre. Kjo teknikë e kombinuar me punën me grupe ndikon në të menduarit kritik të nxënësit, në krijimin e shprehive të shprehurit si dhe në qëndrimin etik të tij gjatë diskutimit e mbrojtjes së një mendimi të caktuar.

Metodat e të Mësuarit Hulumtues

Ndërsa metodat e teknikat e studiuara më sipër ndikojnë në formimin e aftësive të qëndrueshme të nxënësve të çdo niveli, përdorimi i metodave të mësuarit hulumtues mundëson arritje më të larta të nxënies së nxënësve. Këto metoda kanë përparësi në krahasim me metodat shpjeguese tradicionale të mësimdhënies dhe ofrojnë realizimin e veprimtarive motivuese duke u dhënë mundësi nxënësve të mësojnë dhe të praktikojnë aftësi intelektuale dhe të mendojnë në mënyrë logjike.

Shkrimi i eseve

Eseja në gjuhë të huaj konsiderohet si teknikë që mund të zhvillohet me nxënësit që tashmë kanë një paraqitje të përparuar gjuhësore.

Paraqitja e një mendimi, opinionit të plotë, të argumentuar mirë dhe në mënyrë sa më të përmbledhur quhet sot **ese**. Sipas mënyrës së trajtimit esetë janë disa lloje: shpjeguese, krahasuese etj.

Struktura e organizimit të esesë është pothuajse e njëjtë. Ajo përbëhet nga tre pjesë kryesore që janë:

Hyrja, ose pjesa e parë në të cilën pasqyrohet ideja e përgjithshme dhe të gjitha tezat të cilat do të paraqiten në esenë e dhënë.

Trupi i esesë, pjesa e dytë që ndërtohet nga paragrafët (zakonisht 3

paragrafë) dhe ku secili paragraf duhet të japë një ekspoze të qartë për një nga idetë e paraqitura në hyrje.

Përfundimi, pjesa e tretë që paraqet një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore të shqyrtuara në trupin e esesë ose një koment përfundimtar mbi përmbajtjen e esesë.

Që eseja të konsiderohet e arrirë detyrimisht ajo duhet të pasqyrojë në mënyrë të argumentuar mendimin e autorit në raport me çështjen për të cilën është shkruar eseja.

Shembull:

“Le magazine Kult tient une rubrique intitulée “Mon voyage préféré” où il publie les expériences de voyages racontées par ses lecteurs. Vous décidez d’y faire paraître le récit d’un de vos voyages. Présentez-vous, décrivez en détails votre expérience (période, destination, conditions, déroulement, rencontres faites,...)”

Projektet kërkimore

Në projektet kërkimore nxënësi si një anëtar i një grupi, kërkon, thellohet mbi një çështje të caktuar dhe më pas raporton mbi këtë hulumtim.

Që një projekt të ketë sukses domethënë të jetë i realizueshëm nga nxënësit duhet:

- ✓ Projekti nuk duhet të mbulojë një tematikë në një lëndë të caktuar por të përfshijë disa fusha të dijes.
- ✓ Të përcaktohet qartë fusha e projektit qëllimi i realizimit të tij.
- ✓ Për realizimin e projektit të sigurohet bashkëpunim me mësues të lëndëve që lidhen me tematikën e projektit.
- ✓ Të përfshijë masën e nxënësve të grupit, të një klase duke eliminuar çdo përjashtim.
- ✓ Të pranohen objektivat specifike të realizimit të projektit nga zbatuesit e tij.

- ✓ Të përcaktohen grupe për realizimin e detyrave që rrjedhin si domosdoshmëri për realizimin final të projektit.
- ✓ Në përcaktimin e detyrave të konsiderohen niveli, pasionet dhe mundësitë e çdo individi.
- ✓ Projekti mund të përfshijë dhe komunitetin e prindërve të cilët mund të kontribuojnë me mendimet dhe kontribut material për kurorëzimin e projektit.
- ✓ Të përcaktohen fazat e realizimit hap pas hapi të detyrave të projektit.
- ✓ Të përcaktohen detyrat për grupe dhe individ të veçantë duke siguruar në çdo çast bashkëpunimin si një ndër objektivat kryesorë të projektit.
- ✓ Të përcaktohen afate kohore dhe koordinatorët e çdo grupi për realizimin e secilës nga fazat e projektit.
- ✓ Të ndiqen me rigorozitet realizimi global dhe kohor i detyrave individuale dhe të grupit për realizimin e projektit.

Shembull imagjinar projekti me nxënës së klasës së 10-të. Tematika miratohet nga nxënësit që në fillim të vitit shkollor në mënyrë që projekti të ketë marrë formë të plotë në mbarim të studimit të linjës mbi udhëtimet e turizmin⁴.

Strategji të mësuarit, të domosdoshme për formimin e kompetencave gjuhësore.

Realizimi i kurrikulës bërthamë, realizimi i objektivave të mësimeve me objektiva kërkon me domosdoshmëri njohjen e disa nga strategjitë e të mësuarit dhe aplikim të tyre për të arritur paraqitje të larta në mësimin e gjuhës.

⁴ Shembulli ilustron në shtojcën 4.

Le të shohim disa nga strategjitë e të mësuarit që lidhen me krijimin e aftësive të të kuptuarit dhe të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Të dëgjuarit

Strategjitë e të dëgjuarit klasifikohen në dy grupe kryesore sipas objektivave të përcaktuar për realizimin e kësaj aftësie:

- a) Të dëgjuarit për të kapur detaje, si dëgjim i saktë i tingujve, fjalëve e shprehjeve.
- b) Të dëgjuarit për të kapur kuptimin e përgjithshëm të asaj çka dëgjohet në ligjërim.

Mësuesi bën kujdes që gjatë veprimtarive të dëgjimit:

- ✓ Të nëndahet regjistrimi në fjalë, grupe fjalësh dhe fjali.
- ✓ Të përsëritet dëgjimi sa më qartë që të jetë e mundur për të siguruar kuptimin sa më të plotë të ligjërimin.
- ✓ Të ndërhyhet me sugjerime të vazhdueshme për të mbështetur nxënësit për realizimin e detyrës .
- ✓ Të mbahen shënime gjatë dëgjimit me qëllim kuptimin sa më të saktë të dokumentit zanor, ose ligjërimin gojor nga ana e bashkëbiseduesit.

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënësi-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- ✓ Të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- ✓ Të përqendrohet e të zbulojë detaje specifike;
- ✓ Të hamendësojë çfarë flet bashkëbiseduesi e çfarë flitet në magnetofon;
- ✓ Të arsyetojë mbi bazë të asaj që dëgjon;
- ✓ Të përdorë njohuritë e tij të mëparshme;

- ✓ Të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- ✓ Të dëgjojë një tregim, këngë etj, disa herë, për të kuptuar idenë kryesore, duke u përqendruar në fjalët e rëndësishme, në rastin kur nuk kupton gjithçka;
- ✓ Të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- ✓ Të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit;
- ✓ Të përpiqet që gjatë dëgjimit të kuptojë referencat e panjohura kulturore për të;
- ✓ Të sigurohet se detyra është brenda aftësive të tij, duke e konsideruar atë të vështirë por njëkohësisht dhe të arritshme.

Të lexuarit

Më poshtë po listojmë përshkrimet e tre kategorive më të rëndësishme të strategjive të të lexuarit:

- a) Strategjitë të leximit global janë ato teknika të planifikuara me kujdes me anë të cilave nxënësi monitoron të lexuarit.
- b) Strategji në zgjidhjen e problemeve janë procedurat që përdoren nga nxënësit kur janë duke punuar drejtpërdrejt me dokumentin burimor në këtë rast me tekstin.
- c) Strategjitë mbështetëse janë mekanizma bazë mbështetëse për të ndihmuar nxënësin në të kuptuarit e tekstit si p.sh duke përdorur fjalor, duke mbajtur shënime apo duke nënvizuar informacionin e rëndësishëm të tekstit.

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- ✓ Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimit, dy rreshtat e parë të mësimit; të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme.
- ✓ Të gjejë përgjigjet e pyetjeve në tekst, duke përcaktuar paragrafin që i përket pyetjeve.
- ✓ Të kushtojë një vëmendje të posaçme duke ofruar më shumë kohë në dispozicion kur është i vështirë.
- ✓ Të lexojë tekstin për herë të dytë, që të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura.
- ✓ Të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor.
- ✓ Të lexojë paragrafin e parë dhe të fundit për të gjetur idenë kryesore.
- ✓ Të nxjerrë kuptimin të fjalëve të reja.
- ✓ Të nënvijëzojë informacionin e rëndësishëm.
- ✓ Të shmang fjalitë që nuk kuptohen.
- ✓ Të përdorë fjalorin anglisht-anglisht.
- ✓ Të mbajë shënime gjatë të lexuarit.

Të folurit

Gjatë veprimtarive të të folurit bëhet kujdes që:

- a) Të udhëzohen nxënësit në lidhje me kërkesën e veprimtarisë planifikuar për arritjen e objektivit.
- b) Të sqarohen nxënësit për procedurën, duke vendosur limite kohore.
- c) Të njihen nxënësit me kriteret e vlerësimit.
- d) Të monitorohet gjithë-përfshirja e pjesëmarrësve në grup duke përfshirë nxënës të nivelit bazë, të mesëm dhe të përparuar.
- e) Të organizohen nxënësit në grupe ku vihen përballë argumente pro e kundër për tema të interesit si: marrëdhëniet me prindërit, duhanpirja, “braktisja e fshehtë” etj.

- f) Të udhëzohen nxënësit që në debat të ndiqet koherenca e mendimeve, ku për çdo argument pro të jepet një argument analog kundra. P.sh. kur flitet për nxënësit me rezultat të ultë si argument pro mund të jepet e drejta e gjithkujt për arsimim dhe si argument kundra mund të jetë investimi i energjive të nxënësve në angazhimin në punë në rast dështimi në arritjet mësimore.
- g) Të ofrohen skenarë ku nxënësit të pozicionohen në një rol të caktuar për të zgjidhur një problem p.sh, nxënësit punojnë së bashku dhe ndërmarrin një vendim përpara se të realizojnë një punë me role.
- h) T'u ofrohet ndihmë gjatë monitorimit të punës në grupe për fjalë të reja për ta.
- i) Të nxiten nxënësit për të përdorur një sinonim ose të ri-frazojnë mendimin me fjalorin që ata zotërojnë në rast vështirësie në të shprehur.
- j) Të tregohet kujdes që të mos ndërhyhet edhe kur nxënësit gabojnë me qëllim që të mos frenohen dhe të nxitet rrjedhshmëria e të folurit.
- k) Të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve në fund të çdo veprimtarie përmes shënimeve që mësuesi ka marrë gjatë realizimit të tyre. Shpesh këshillohet që të regjistrohen disa veprimtari me qëllim që nxënësit të bëjnë edhe vetëvlerësimin e tyre.

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- ✓ T'i kërkojë folësit të përsërisë çfarë tha, në rast moskuptimi;
- ✓ Të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura;
- ✓ Të përsërisë një pjesë të asaj çka thotë bashkëfolësi, për të miratuar se biseda ndërmjet tyre po përcillet në mënyrë të drejtë kuptimore;

- ✓ Të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.
- ✓ Të përdorë përshkrimin me fjalë të njohura, kur nuk di kuptimin e një fjale të dhënë;
- ✓ Të bëjë bisedë të ndërsjellë me bashkëbiseduesin

Të shkruarit

Për të realizuar veprimtaritë që zhvillojnë aftësitë e të shkruarit mësuesi sigurohet që:

- a) Të udhëzohen nxënësit të identifikojnë kërkesën e detyrës me shkrim. Mësuesi kontrollon kuptimin e detyrës duke i pyetur nxënësit p.sh: çfarë do të shkruani? (letër). Kujt po i shkruani? (shokut) Çfarë stil shkrimi do të përdorni? (informal) Për çfarë do të shkruani në letër? (Ç'bën ti për të mbajtur lagjen tënde të pastër?)
- b) T'u jepet kohë nxënësve për të bërë "brainstorming"(ide). P.sh, nxënësit shënojnë në një diagram idetë në lidhje me temën pa u shqetësuar për organizimin e tyre.
- c) Të bashkëpunohet në grup ose në çift për të zgjeruar idetë dhe për t'i sistemuar ato.(nxënësit në rastin konkret mund të shtojnë ide mbi mënyrën e përmirësimit të ambientit pranë shkollës ose lagjes si:krijimi i parqeve, mbjellja e pemëve, pastrimi i ndërtesës dhe vendosja e koshave.
- d) Të kontrollohet qartësia e mendimit duke bërë përmirësimet e duhura në fjalor.
- e) Të qartësohen nxënësit mbi karakteristikat e llojit të shkrimit, p.sh, përfshirja e formave të shkurtuara, fjalorit të përditshëm dhe foljeve frazeologjike.
- f) Të kontrollohet përdorimi i shenjave të pikësimit dhe germëzimit të fjalëve.

- g) Të shkëmbehet detyra me shokun për t'u motivuar dhe ndërgjegjësuar mbi pikat e forta dhe të dobëta në realizimin e detyrës me shkrim. Kjo procedurë kwshillohet për të zvogëluar presionin e gjykimit të mësuesit si vlerësues kompetent.

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji si në klasë ashtu edhe në mënyrë të pavarur:

- ✓ Të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- ✓ Të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar;
- ✓ Të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj;
- ✓ Të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- ✓ Të redaktojë shkrimin e tij ose të këmbejë punën e tij më atë të shokut.

3. Vlerësimi i nxënësit

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat programin lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti, ndonëse matja e tyre mbetet problematike.

Duke vlerësuar kurrikulën bërthamë të gjimnazit në kornizën e Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët, theksojmë që kriteret dhe mënyrat e vlerësimit në këtë nivel duhen përshtatur me kërkesat e nivelit B1 të vlerësimit të arritjeve. I takon çdo mësuesi krahas formulimit të objektivave të qartë në përputhje me kurrikulën dhe Kuadrin Evropian të Referencave për Gjuhët të bëjë dhe vlerësimin hap pas hapi të çdo kompetence të nxënësit.

Për mësuesin e gjuhës së huaj, të vlerësosh nxënësin do të thotë të vlerësosh kompetencat e tij në komunikimin me shkrim e me gojë, duke vlerësuar hap pas hapi çdo aftësi e arritje të nxënësit. Vlerësimi i njohurive, aftësive, qëndrimeve të nxënësve është një nga proceset bazë që qëndron në themel të mësuarit. Vlerësimi i nxënësit është një përgjegjësi e rëndësishme dhe kërkon të mbështetet në parametra bashkëkohorë.

Vlerësimi përdoret:

- Për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm mbi përparimin e nxënësve, motivimin e tyre drejt të mësuarit, dhe

- përcaktuar mundësitë reale të nxënësve për nxënie të mëtejshme;
- Për të vlerësuar përparësitë, dobësitë në arritjet e nxënësve dhe shkaktarët e situatës së dhënë;
 - Për të nxjerrë të dhëna mbi arritjet përfundimtare të nxënësve gjatë të mësuarit.

Etapa të vlerësimit

Vlerësimi kalon përmes disa etapave të cilat përfshijnë kontrollin, matjen dhe vlerësimin.

Kontrolli lidhet me rrugën e përfutimit të informacionit mbi atë që ka arritur dhe atë që nuk ka arritur nxënësit gjatë të mësuarit. Kontrolli realizohet në forma të ndryshme dhe në çdo moment të mësuarit.

Matja shpreh rezultatin e kontrollit krahasuar me kushte, me kritere, standarde të caktuara paraprakisht dhe paraqitet në pikë, përqindje etj. Duhet thënë se jo çdo kontroll përfundon me matje.

Vlerësimi lidhet me vendosjen e vlerës me anë të notës, shprehjes me fjalë (keq, mirë, shumë mirë etj) në përputhje me gjykimin sasior, cilësor që rezulton nga kryerja e matjes.

Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Duke mbajtur parasysh se vlerësimi përmban gjithmonë edhe një dimension afektiv, mësuesi mund të përdorë edhe vetëvlerësimin ose vlerësimet në grup.

Ja disa veprimtari të vogla ose kërkesa për vetëvlerësimin formues:

- ✓ të shpjegohen objektivat pedagogjike të veprimtarive;
- ✓ pas një veprimtarie të caktuar, bëhet një pushim. Pastaj shtrohet pyetja “Çfarë keni mësuar?... ose çfarëdo lloj pyetje që konsiderohet e përshtatshme dhe në lidhje me temën.”

- ✓ t'i kërkohet rregullisht nxënësit të bëjë bilancin e njohurive të ndryshme;
- ✓ të shpallen provimet e vlerësimit përmbledhës dhe të përcaktohen paraprakisht kriteret e suksesit;
- ✓ në një situatë sukcesi, të pyeten nxënësit “Çfarë bëtë për të pasur sukses?” dhe të nxiten ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
- ✓ pas një krijimi me shkrim, t'i kërkohet nxënësit të tregojë çdo gjë për të cilën është i sigurt në tekstin e tij.
- ✓ në rast mëdyshjeje mbi një formë ortografike, leksikore ose morfologjike, t'i kërkohet nxënësit ta shënojë këtë formë në tekstin e tij dhe të hartojë pyetjen në fund të faqes në formë shënimi (mësuesi i përgjigjet në të njëjtën mënyrë).

Gjithashtu mund t'i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetë-korrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta ose ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.

SHTOJCË 1: Pjesëmarrje në veprimtarinë e javës së anglofonisë, frankofonisë etj., në shkallë lokale, kombëtare a më gjerë

Kjo veprimtari kërkon azhurnimin me aktivitetin anglofon/frankofon, etj., në shkallë lokale, kombëtare dhe më gjerë; azhurnim që mund realizohet nga mësuesi apo vetë nxënësit që në muajin janar të çdo viti duke shfrytëzuar TIK. Përdorimi i internetit ndihmon për prezantimin e 10 fjalëve të anglofonisë ose frankofonisë, për festimet e muajit mars në shkallë lokale dhe kombëtare. Njëkohësisht u lihet kohë nxënësve për të paraqitur mendimet e tyre se çfarë mund të realizohet, në klasën e tyre, në shkollën apo rrethin përkatës.

Ndërkohë prezantohen dhe veprimtaritë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadrin e anglofonisë ose frankofonisë dhe shihet konkretisht

nga vetë nxënësit se çfarë mund realizohet praktikisht nga vetë ata.

Sigurisht në vartësi me nivelin, prirjet interesat e nxënësve të veçantë dhe grupit në përgjithësi vendoset për natyrën e veprimtarisë e cila mund të jetë:

- a. Ekspozitë pikturë ose fotografike bazuar me “10 fjalë të anglofonise ose frankofonisë 200...”
- b. Konkurs me krijime letrare
- c. “10 Fjalët e anglofonise ose frankofonisë” të përdorura në kontekste të ndryshme, socio- kulturore nga mendje të ndritura të mendimit njerëzor.
- d. Pjesëmarrje aktive e klasës në veprimtarinë kombëtare, ndërkombëtare të anglofonisë ose frankofonisë.

Sigurisht kjo veprimtari organizohet në varësi nga ajo çfarë kanë zgjedhur vetë nxënësit, dhe ndiqet sipas afateve të përcaktuara nga vetë ata për të kurorëzuar veprimtarinë e tyre në rang lokal, kombëtar apo ndërkombëtar.

Është e një rëndësie të veçantë organizimi, ndarja e detyrave sipas një rregullsie dhe radhe të përcaktuar drejt në vartësi shpesh dhe të vetë prirjeve duke realizuar kështu zhvillimin e talenteve por dhe hapjen e horizonteve për jetën profesionale.

SHTOJCE 2: Diagrama e Venit

Karakteristika të përbashkëta

Common characteristics/Traits communs –

Touristic villages/village touristique

Albania/Albanie - village en voie de developpement –

eaux limpides – bois - petits hôtels – générosité

Karakteristika të veçanta, individuale

Individual characteristics

Traits particuliers, individuels

Dhërmi

South....at the foot of the mountain,

Sud au pied de la montagne, mer, côtes rocheuses, flore méditerranéenne.

Theth

North

Nord au milieu des montagnes, fleuve, cascade, monts en pique, flore continentale, petites maisons alpines.

Nxënësit mund të shtojnë elementë të rinj në secilën nga pjesët dhe ballafaqojnë njohuritë. Nga ana e mësuesit kjo teknikë mund të aplikohet në fazën e reflektimit, apo në momentin e pyetjeve të kuptuarit, në orët e përsëritjeve etj.

Më pas mund të kalohet në mbledhjen e gjithë elementëve dhe hartimin e një materiali përshkrues me shkrim ose më gojë për secilën nga zonat.

SHTOJCE 3: Tabela T.

Jeni për apo kundër ndërtimeve të larta në bregdet

Argumente “pro”

Argumente “kundër”

SHTOJCE 4: “ Guide turistike e krahinës » dhe planifikimi i projektit

Shkolla _____

Klasa _____

“Guide turistike e krahinës”

Qëllimi i projektit: *Përgatitja e një guide turistike të krahinës.*

Objektiva specifike:

- ✓ Angazhimi i nxënësve në veprimtari kërkimore.
- ✓ Ndërveprimi i gjuhës së huaj, asaj frënge me lëndët e tjera të rëndësishme për formimin dhe arritjen e objektivit përfundimtarë të këtij aktiviteti.
- ✓ Thellimi i njohurive në gjuhës së huaj.
- ✓ Thellimi i dijeve mbi krahinën, historinë, monumentet dhe mundësitë për progres dhe zhvillim.
- ✓ Të përforcohet bashkëpunimi i nxënësve rreth një pune kolektive.

Persona të angazhuar:

Grupi i nxënësve të klasës..... anglisht/frëngjisht/italisht etj,
drejtuar nga mësuesja Znj.Mësuesi i historisë.

Znj..... Mësuesja e gjeografisë

Znj.....

Persona të interesuar për projektin:

Bashkia e Qytetit

Shoqata e historianëve.

Biznesi në krahinën e

Planifikimi i Projektit : Shtator 2010 – Nëntor 2010

Faza e parë_– Njohje dhe prezantim i projektit.

15shtator - 5 Tetor

Qëllimi: Njohja e problematikës, prezantim i veprimtarive të mundshme, të domosdoshme për realizimin e projektit.

- ✓ Njohje e problematikës së turizmit në krahinë dhe veçoritë e saj.
- ✓ Çfarë përfaqëson një guide? -Përcaktim i aspekteve më të rëndësishme për krahinën.
- ✓ Ndarje e punës me grupe duke fiksuar objektiva të veçantë për secilën fushë kërkimi.

Faza e dytë: Redaktimi i një dosjeje mbi historinë dhe gjeografinë rajonale (krahinore)

6 tetor – 22 nëntor

Objektivi: - Thellimi i njohurive për historinë dhe gjeografinë e krahinës.,
- Konceptimi i afisheve “Parajsa natyrore e krahinës sime”

Faza e tretë : Realizimi dosjes së parashikuar (guidës) *22 – 5 shkurt*

Synimi

1. Informatizim i gjithë kërkimit.
2. Përgatitje me kontributin e gjithë komunitetit të Guidës Turistike të krahinës.

Çdo fazë do ndiqet me rigorozitet duke bashkërenduar punët individuale me ato kolektive. Në fund mësuesi mund të organizojë një tavolinë të rrumbullakët me pjesëmarrje nga përfaqësues të komunitetit të nxënësve dhe prindërve në shkollë ku secili nga nxënësit mund të shprehet për emocionet dhe përvojat e fituara pas projektit.

